



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

---

Nr. 25/2 Prot.

Tiranë, më 25/7/2011

**Lënda:** Rekomandim për “**Eder Studio**” Tiranë.

**REKOMANDIM**

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, “**Instituti i dobësimit Orchid**” Tiranë,

**KONSTATOVA**

Më datë 16/05/2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, “**Instituti i dobësimit Orchid**” Tiranë, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së shtetasit me inicialet A.B, lidhur me mesazhet promovionale të dërguara nga “**Instituti i Dobësimit Orchid**”.

Komisioneri “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi “**Instituti i Dobësimit Orchid**” ka dërguar komunikime tregtare me karakter reklame përmes mesazheve të tipit sms-të shkruara, drejt numrave të ndryshëm përdoruesish të telefonisë celulare ( AMC, Vodafon, Eagle), pa marrë pëlqimin paraprak nga subjektet e të dhënave personale, (mbajtës dhe përdorues të numrave të telefonave celularë) për ofrimin e këtij shërbimi.

Nga inspektimi administrativ i kryer rezultoi se dërgimi i sms-ve promovionale është bërë nga vetë administratorja e këtij kontrolluesi. Mesazhet promovionale janë realizuar nëpërmjet blerjes së një shërbimi për dërgim mesazhesh në internet, ofruar nga kontrolluesi “**Eder Studio**”.

Kontrolluesi “**Eder Studio**” veç shërbimit të ofruar për dërgim mesazhesh nga interneti, rezulton se, i ka vënë në dispozicion kontrolluesit “**Instituti i Dobësimit Orchid**”, administratores së saj, një listë numrash telefoni celularë të klientëve të tij (subjekte të të dhënave personale), pa marrë pëlqimin paraprak (të shprehur) të këtyre klientëve, për përhapjen e këtyre të dhënave drejt subjekteve të treta.

Dërgimi i komunikimeve tregtare me karakter reklame përmes mesazheve të tipit sms të shkruar, drejt numrave të ndryshëm të përdoruesve të telefonisë celulare (AMC, Vodafon, Eagle), në vështrim të nenit 3 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konsiderohet mbledhje dhe përpunim i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave ( përdorues të numrave të telefonit), pasi numri i telefonit celular është një e dhënë personale ngushtësisht private i cili të çon në identifikimin e individit.

Dërgimi i komunikimeve tregtare me karakter reklame (ose promocion) përmes mesazheve të tipit sms, drejt numrave të ndryshëm të telefonisë celulare të subjekteve të të dhënave personale (mbajtës dhe përdorues të këtyre numrave celularë), duhet të bëhet duke respektuar kushtet dhe kriteret që parashikon ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, veçanërisht nenin 6 të tij i cili specifikon se:...” *Të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin*”.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

## REKOMANDOJ

**Në zbatim të nenit 6 pika 1/a të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi “Eder Studio” të mos përhapë tek të tretët të dhëna personale (numra të telefonave celularë të klientëve të vet) pa pëlqimin e qartë dhe të shprehur të këtyre subjekteve të të dhënave personale.**

**Në zbatim të nenit 5 pika 1/c të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “Eder Studio” të mos tejkalojë qëllimin e përpunimit të të dhënave personale të klientëve të tij.**

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

